REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 324/20
Data/Datum 15.06.20
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili	28.05.2019	*15.06.2020*	324/20
	Data e autorizimit të ekspertit	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë 26.05.2020, OE :"**UrbanInvest**", ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.**324/20,** kundër njoftimit për anulim, në lidhje me aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me jelek reflektues dhe doreza**" me nr. të prokurimit: **214-19-9532-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës (PK).

Data e njoftimit për kontratë 13.12.2019, data e parashikuar e hapjes së ofertave 13.01.2020, data e kërkesës për rishqyrtim 16.05.2020, vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim 19.05.2020.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore sipas nenit 113, te LPP-së.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Gjate ri-vleresimit te ketij aktiviteti te prokurimit jane shkelur:

Neni 59.2 i LPP-së
Neni 59.4 i LPP-së
Neni 60.1.1 i LPP-së dhe RRUOPP -Neni 4, pika 4.4

Neni 59.2 i LPP-së sqaron se Autoriteti kontraktues duhet në raste të tilla të vazhdojë duke kërkuar sqarim në bazë të nenit 59.2 të LPP. Kuantifikimi i devijimeve të vogla ka për qëllim të neutralizimit të efektit që këto devijime do të kenë në krahasimin e tenderëve.

Ky nen nuk eshte konsideruar nga ana e komisionit dhe nuk jemi kontaktuar per te dhene sqarime.

Nem 59.4 i LPP-së sqaron se Autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale

ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çjarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Konsiderojme se ky nen nuk eshte marre parasysh, pasi dallimi tek shkronjat POLICE per lmm dhe 4 mm te cilat edhe nuk mund te verehen ne dukje te lirë mund te kuantifikohet lehte gjate prodhimit dhe nuk do te duhej te ishte arsye per eliminim, kurse dendesia e materialit qe thuhet se eshte 190gr/m2 nuk qendron sepse ne jemi kujdesur qe prodhuesi te ofrojë gramazhen e njejte dhe te njejten na e ka konfirmuar , kurse AK nuk ka deshmuar se si e ka bere kete matje pasi matjet e tilla behen vetem nga laborator te certifikuar e jo ne ndonje menyre tjeter.

Neni 60. 1.1 i LPP-së nuk eshte marre parasysh edhepse ne kemi dorezuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët: Dhe sic shihet nga letrat standarde jemi te vetmit qe kemi qene pjese e rivleresimit,pasi OE nuk e ka vazhduar Sigurimin e Tenderit duke u treguar i papergjegjshem dhe qellimkeq vetem per ta vonuar kete aktivitet prokurimi.

RRUOPP -Neni 4, pika 4.4 Profesionalizmi - Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira., ne mendojme se AK nuk ka dhene mendim te bazuar ne ligj për pikat qe i shprehem me lart.

Gjithashtu ne kemi marre edhe Raportin e Ekspertit Shqyrtues te Angazhuar nga OSHP per kete aktivitet te prokurimit me nr. 152/20 i dorezuar me dt. 17.04.2020 ku vlereson se nuk ka pasur shkelje nga ana e komisionit te meparshem dhe ka hedhur poshte te gjitha pretendimet e OE ankues .

Andaj kerkojme nga ana juaj qe kete ankese ta rishqyrtoni dhe te shperblehemi me kontrate si OE i vetem i pergjegjshem ne kete aktivitet te prokurimit.

Dëmet Materiale : 2000 EURO

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë: a) Deklarata nën betim se operatori ekonomik përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë neni 65 të Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin. No. 05 L-092, do të dorëzohen në formë të Aneksit 2.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* a) Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.
		b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të	b) Vërtetim nga Administrata Tatimore

		themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës	
		c) Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.	c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal kopje e noterizuar
		d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxherët e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.	d)Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.
		Dokumentet (nën b dhe c dhe d) duhet të dorëzohen nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë.	
<u>Kërkesat e përshtatshmëri së profesionale</u>	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale Kërkesa 1: Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës)	*Dështmia e kërkuar dokumentare:* Dështmi 1; Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit- (kopje)
		Kërkesa 2: Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore)	Dështmi 2 Kopja e certifikatës së TVSH-së(kopje)
		Kërkesa 3: Certifikata e numrit	Dështmi 3 Kopja e certifikatës së

		fiskal (vetëm për kompanitë vendore)	numrit fiskal (kopje)
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar /realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo te ngjashëm për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) minimum dy kontrata të përfunduar/realizuar.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Dëshmi 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit.
		Kërkesa 2 Operatorët Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë nga një mostër për secilin artikull **sipas spacifikacioneve teknike** Aneksit 1	Dëshmi 2 **Mostrat duhen dorëzuar për secilin artikull** para datës së pranimit të ofertave ora 14: 00.

Nr.	Përshkrimi i specifikacioneve të detyrueshme	Njësia	Sasia
	Dorëza Dimri		
1	Materiali: Origjinal Lëkurë e butë – Hidrofobike (Rezistente ndaj ujit) Materiali i brendshëm të jete 100% Kashmir lesh natyral. Materiali i jashtëm 100% Lëkurë e butë Të përshtatshme për punë Policore (për përdorim te Armës, prangave etj.) Dorëzat duhet të ofrohen në dizajnë të njejtë, për meshkuj dhe për femra, (dallimi vetëm në numra). Dorëzat në pjesën e kyqit të dorës duhet të jetë më e ngushtë (Elastike) dhe të jetë e thurur. Në pjesën e sipërme të shuplakës ti ketë tre tegela të thurur, Të ketë minimumin gishtin e madh dhe gishtin tregues me prekje sensitive. Ngjyra- e zezë Madhesite nga XS-3XL 	Palë	14000
	Jelekë reflektues	copë	3000
2	**Materiali** - 100 % poliester, , trashësia (dendësia) e materialit të jetë **130-150 gram** / 1m2, dhe të jenë të rezistueshëm ndaj ujit ... (ëhaterproof); - Shiriti fosforik- reflektues (ndriçues) duhet të jetë origjinal dhe gjerësia e saj të jetë **5 cm** në të dy anët e jelekut, kurse pjesa mbrapa ku bëhet qepja e logos (POLICE – ngjyrë e kuqe), dhe madhësia e shkronjave mbrapa duhet të jet **8-9 cm**. shirit apo fosfori të jetë 10cm x 30cm; Logo në pjesën e perparme mbishkrimi (POLICE – ngjyrë e kuqe) duhet te jet madhësia e shkronjave 2cm. - Logo duhet të jetë e qepur (qëndisur) dhe e përforcuar mirë, e qëndrueshme		

gjatë larjes, në pjesën mbrapa dhe dimensioni i saj të jetë përafërsisht 26 – 28 cm gjatësia, kurse në pjesën para të jetë e shtypur me ngjyrë në anën e majtë të gjoksit;

- Duhet të ketë mbyllje me zingjir (patent me kvalitet) te jetë i rezistueshëm ndaj ujit dhe larjes;
- Se cili jelek duhet te ketë paketim të veçantë dhe kompakt;
- Gjatësia nga shiriti refletues i fundit duhet të jetë nga 8 cm-deri 10 cm.



RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES (LETRA STANDARDE PER ELIMINIM)

ARSYETIM

[Jti jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refiizuar] për këto arsye :

Kompania " URBAN INVEST" nuk i plotson specifikat teknike te kerkuara; Artikulli numer 1. jelek reflektues, a) Eshtë kërkuar në dosje të tenderit: pesha e materialit është kerkuar të jetë **130-150 gram/1m2** - ndersa Operetori Ekonomik jelekun e ka ofruar me pesh **190 gram**. b) Është kërkuar: Mbrapa jelekut ku bëhet qepja e llogos (POLICE-ngjyrë e kuqe), dhe madhsija e shkronjave mbrapa duhet të jetë **8-9 cm** - ndersa Operatori Ekonomik ne mostren e ofruar e ka madhsin e shkronjave të ndryshme **7.6 cm** ndersa shkronja (O) dhe shkornja (C) janë me dimenzion **7.9 cm**, që do te thotë nuk janë dimenzionet siç është kerkuar në dosje të tenderit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KËRKUARANGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit Paneli Shqyrtues i OSHP-së, ka nxjerrë vendimin numër 152/20.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Urban Invest"

Përgjigje në pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e parë ankimorë, OE pretendon se "*...dallimi tek shkronjat POLICE per lmm dhe 4 mm te cilat edhe nuk mund te verehen ne dukje te lirë mund te kuantifikohet lehte gjate prodhimit dhe nuk do te duhej te ishte arsye per eliminim...*", sqarojmë se kërkesë e dosjes ka qenë që :

"Kërkesa 2 Operatorët Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë nga një mostër për secilin artikull **sipas spacifikacioneve teknike".**

Vlenë të theksohet se AK për këtë specifikacion teknik ka lejuar një tolerancë rreth 10%, kur kanë potencuar "*...madhësia e shkronjave mbrapa duhet të jet **8-9 cm**"*, me gjithë këtë OE ankues (bazuar në vet ankesën e tij nr.324/20) nuk ka arritur të ofroj mostër brenda tolerancës së caktuar nga AK.

Sa i përket pretendimit rreth materialit të jelekut, ku AK ka konstatuar se në vend të peshës **130-150 gram** / 1m2, OE ankues ka ofruar material prej 190 gram/1m2, OE pretendon se "*...jemi kujdesur qe prodhuesi teofrojë gramazhen e njejte dhe te njejten na e ka konfirmuar , kurse AK nuk ka deshmuar se si e ka bere kete matje pasi matjet e tilla behen vetem nga laborator te certifikuar e jo ne ndonje menyre tjeter*", konsiderojmw se pretendimi ankimorw nw kwtw pikw wshtw pjeswrisht i bazuar.

Vlenë të theksohet se për këtë aktivitet të prokurimit OSHP me 24.04.2020, ka marrur vendim me nr.152/20, në arsyetim të të ciit vendim thuhet :

"***Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka pasur parasysh kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit, ku jeleku reflektues dhe dorëzat nuk i përmbajnë specifikat teknike sikurse është kërkuar në dosje të tenderit.*** *Po ashtu, edhe tek kërkesa që ka të bëjë me listën e kontratave, fletëdërgesë, faturë, etj. AK duhet që të sigurohet se OE i rekomanduar për kontratë i posedon.*

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe shqyrtimit

të pretendimeve ankimore ***vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht e obligon autoritetin kontraktues se gjatë ri-vlerësimit tëofertave të veproj konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, si dhe të vlerësoj drejt ofertat e operatorëve ekonomik*** *".*

Përgjigje në pretendimin nr.2

Sa i përket pretendimit ankimorë kundrejt OE tjetër ofertues ku OE ankues deklaron se : "*OE nuk e ka vazhduar Sigurimin e Tenderit duke u treguar i papergjegjshem dhe qellimkeq* ***vetem per ta vonuar kete aktivitet prokurimi****".*

Sqarojmë se ky pretendim ankimorë është pretendim sugjestiv i OE ankues dhe eksperti shqyrtues në çfardo mënyre e ka të pamundur të konfirmoj ose mohoj një pretendim të tillë ankimorë.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart vlerësojmë se gjatë procedurës së rivlerësimit AK ka vepruar në pajtim me vendimin e OSHP-së nr.152/20.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së njoftimi për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Policia e Kosovës
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – Urban Invest